



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:000712

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05832167

KE.nr. 670/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit Shoqëria për Inxhiniering dhe Qarkullim LITING DOOEL Eksport – Import me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me adresë në Bul. Koqo Racin, nr.8, Shkup, kundër të paditurës Ndërmarrja Tregtare Private Metal Projekt Gjilan me seli në Gjilan, rr. “Ramiz Sadiku” nr. 3/3, me objekt kontesti pagesë e borxhit, vlera e kontestit 3,217.30 EUR jashtë seancës gjyqësore, me datë 18.06.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Shoqëria për Inxhiniering dhe Qarkullim LITING DOOEL Eksport – Import me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Ndërmarrja Tregtare Private Metal Projekt Gjilan, që në emër të mallit të dorëzuar dhe të papaguar sipas faturave nr. 050/2013 të datës 22.10.2013, nr. 09/2014 të datës 24.03.2014 dhe nr. 020/2014 të datës 26.15.2014 , t’ia paguaj paditësit shumën prej 3,217.30 EUR me kamatë ligjore nga data 09.09.2018 e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, Shoqëria për Inxhiniering dhe Qarkullim LITING DOOEL Eksport – Import me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut me datë 27.12.2019 pranë Gjykatës Themelore në Gjilan ka

paraqitur padi kundër të paditurit Ndërmarrja Tregtare Private Metal Projekt Gjilan me objekt kontesti pagesë e borxhit.

Në padinë e tij, ka theksuar se paditësi, disa herë i ka dorëzuar mallra të paditurit, për të cilat i ka lëshuar faturat nr. 050/2013 të datës 22.10.2013, faturën nr. 09/2014 të datës 24.03.2014 dhe faturën nr. 020/2014 të datës 26.15.2014. Ka shtuar se i padituri, disa herë ka kryer pagesa sipas këtyre faturave dhe i ka mbetur borxh paditësit shumë prej 3,217.30 EUR, për të cilin borxh palët kanë prolonguar afatin e pagesës deri në fund të muajit nëntor të vitit 2018. Ka shtuar se padi që i padituri nuk ka paguar borxhin as pas afatit shtesë të dhënë nga paditësi, ky i fundit ka interes juridik për të iniciuar këtë padi për t'i inkasuar kërkesat e veta. Andaj ka kërkuar që të aprovet si e bazuar padia e paditësit dhe të detyrohet e paditura Ndërmarrja Tregtare Private Metal Projekt Gjilan që në emër të mallit të dorëzuar dhe të papaguar, t'ia paguaj paditësit shumë prej 3,217.30 EUR me kamatë ligjore nga data 09.09.2018 e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktvendimin C.nr. 28/20 të datës 16.11.2020 ka obliguar të paditurin që të paraqes përgjigje në padi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i padisë nën kërcënim të pasojave procedurale.

Lënda në fjalë, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale, në bazë të kompetencës lëndore është transferuar për shqyrtim të mëtejme pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkalles së Parë.

E paditura, me parashtrësën e datës 08.11.2022, ka njoftuar Gjykatën se pas pranimit të aktvendimit për përgjigje në padi, i padituri ka filluar me pagesën e borxhit ndaj të paditurit ashtu që me datë 10.01.2020 ka bërë pagesë për paditësin në vlerë prej 1,000.00 EUR, me datë 30.11.2020 ka bërë pagesë për paditësin në vlerë prej 1,100.00 EUR dhe me datë 18.05.2021 është bërë pagesa për paditësin në vlerë prej 1,117.30 EUR, ashtu që borxhi i kërkuar nga paditësi me padi është përmbushur në tërësi. Andaj ka shtuar se lënda në fjalë nuk është dashur të transferohet për Gjykatën Komerciale të Kosovës.

Gjykata, pas pranimit të parashtrësës së datës 08.12.2022 të cilën e trajtoj si përgjigje të të paditurit në padinë e paditësit, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuar në nenin 399 të LPK-së, sepse nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë.

Gjykata, nga provat e bashkangjitura nga i padituri me padi, gjeti se borxhi i kërkuar nga paditësi në vlerë prej 3,217.30 EUR, borxh ky i papaguar sipas faturave nr. 050/2013 të datës 22.10.2013, nr. 09/2014 të datës 24.03.2014 dhe nr. 020/2014 të datës 26.15.2014 është përmbushur në tërësi nga i padituri. Këtë fakt gjykata e vërtetoi nga dëshmia bankare e datës 10.01.2020, nga e cila rezulton se i padituri ka paguar për paditësin shumën prej 1,000.00 EUR për faturën 020/2014, dëshmia bankare e datës 30.11.2020, nga e cila rezulton se i padituri ka paguar për paditësin shumën prej 1,000.00 EUR për faturën 020/2014 dhe dëshmia bankare e datës 18.05.2021 nga e cila rezulton se i padituri ka paguar për paditësin shumën prej 1,117.00 EUR për faturën 020/2014, apo në total shumën prej 3,217.00 EUR.

Tutje gjykata gjeti se pagesat e lartcekura, janë ekzekutuar nga i padituri për llogari të paditësit pas inicimit të procedurës gjyqësore nga ky i fundit dhe se shuma e paguar nga i padituri, përputhet me shumën e borxhit të cilën palët ndërgjyqëse ishin marrë vesh sipas procesverbalit për dakordimin e borxhit të datës 08.08.2018, dhe e cila shumë është kërkuar nga paditësi me padi.

Nga kjo gjendje faktike e konstatuar, gjykata për vendosje në këtë çështje iu referua nenit 399 par.1 të LPK-së i cili parasheh se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”* lidhur me paragrafin 2 të këtij neni i cili përcakton se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Në mbështetje të dispozitave të lartcekura, e meqenëse nga provat e bashkangjitura nga i padituri përmes përgjigje në padi rezulton se borxhi i kërkuar nga paditësi është përmbushur në tërësi nga ky i fundit, rezulton se tanimë ka pushuar themelësia e padisë së paditësit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në dispozitat e neneve 450 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura me lart dhe bazuar në dispozitat e nenit 399 të LPK-se, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 670/22, datë 18.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.